BMF BUTRINT MANAGEMENT FOUNDATION

Butrint më 27.10.2026

Lënda: Sqarimi nr. 1 i Kërkesës për Tender ref. 013/2026 “Prodhimi dhe Furnizimi me fletëpalosje të printuara për Parkun Kombëtar të Butrintit”

Nr.	Pyetja	Referenca në Dokumentin e Tenderit	Përgjigjja	Sqarim / Amendim
1	Në kuadër të procedurës së prokurimit me objekt **"Prodhimi dhe Furnizimi me fletëpalosje të printuara për Parkun Kombëtar të Butrintit"**, bashkëlidhur këtij emaili ju dërgojmë në format PDF dy vërtetimet e marra nga gjykata për subjektin tregtar XX, me NIPT XX. Në dokumentacionin e tenderit janë përcaktuar kriteret e mëposhtme: 1. Vërtetim se ofertuesi nuk është dënuar për shkelje penale dhe nuk është nën proces hetimi nga organi i prokurorisë. 2. Vërtetim nga gjykata se subjekti nuk ka proces gjyqësor të hapur në cilësinë e palës së paditur. Ju lutemi të na konfirmoni nëse dy vërtetimet e bashkëlidhura janë të mjaftueshme për përmbushjen e kritereve të mësipërme apo nëse nevojitet të paraqesim dokumentacion tjetër plotësues, veçanërisht për kriterin e parë, që lidhet me dënimin	Kërkesa për Tender, paragrafi 3.4, pika a.	Sqarojmë se, në këtë fazë të procedurës së prokurimit, nuk mund të jepet një vlerësim paraprak mbi vlefshmërinë apo mjaftueshmërinë e dokumentacionit të ofertuesve. Shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit për përmbushjen e kritereve të kualifikimit është kompetencë e Komitetit të Vlerësimit të Tenderit dhe kryhet gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Ju kujtojmë gjithashtu se, sipas pikës 3.4 të Kërkesës për Tender, për kriteret 3–10, në fazën e dorëzimit të ofertave kërkohet plotësimi i Formularit nr. 3 – Formulari i Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni vërtetues për kriteret 3–7 do të kërkohet nga ofertuesi i renditur i pari në klasifikim.	Sqarim

	penal dhe procesin e hetimit nga organi i prokurorisë.			